

## VIZE PER TRAJTIM SHENDETESOR

Viza për Trajtim Shëndetësor i lejon hyrjen në Itali atij personi i cili ka nevojë t'i nënshtrohet trajtimeve të ndryshme mjekësore pranë institucioneve shëndetësore publike dhe private italiane, të akredituara pranë Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, si edhe personit që eventualisht e shoqëron atë.

*Çdo banor i Kosovës i cili kërkon vizë hyrjeje në Itali për Trajtim Shëndetësor duhet të paraqitet personalisht (ose, në rast se kjo është e pamundur për shkak të sëmundjes, të autorizojë një familjar) pranë Sportelit të vizave të Ambasadës Italiane në Prishtinë në ditën e në orën e caktuar dhe t'i dorëzojë personelit përkatës "Formularin e kërkesës për vizë" me dy fotografi aktuale sipas standardit ICAO, të mbushur në të gjitha pjesët e tij me gërma të mëdha shtypi.*

*Kërkesës për vizë duhet t'i bashkangjiten dokumentet e poshtëshënuar si edhe një fotokopje e qartë e tyre:*

- 1) **Pasaportë ose Dokument Udhëtimit të vlefshëm** deri në skadimin e afatit të vizës së kërkuar;
- 2) **Vërtetim mbi gjendjen shëndetësore dhe mbi patologjinë e pacientit** i lëshuar nga Klinika përkatëse pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë dhe i përkthyer në gjuhë italiane nga një përkthyes gjyqësor i njohur nga Ambasada Italiane në Prishtinë;
- 3) **Deklarata e strukturës shëndetësore italiane** të zgjedhur për kryerjen e trajtimit mjekësor në të cilën të tregohen saktë dhe shprehimisht:
  - a) lloji trajtimit mjekësor;
  - b) data e fillimit të trajtimit mjekësor;
  - c) kohëzgjatja e tij;
  - d) shuma e shpenzimeve financiare të nevojshme për trajtimin mjekësor në fjalë (DRG).
- 4) **Vërtetimi i po së njëjtës strukturë shëndetësore** ku të vërtetohet derdhja e një paradhënie të barabartë me min. **30 %** të totalit të shpenzimeve financiare të nevojshme për trajtimin mjekësor;
- 5) **Dokumente të ndryshëm që vërtetojnë mbajtjen në Itali të mjeteve financiare** të mjaftueshëm për të paguar mbetjen prej 70 % të shpenzimeve shëndetësore të përcaktuara në deklaratën e strukturës shëndetësore italiane (shih pika 2) si edhe të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me jetesën dhe qëndrimin në Itali të shoqëruesit (buste paga të mjaftueshme ose fideus bankar);
- 6) **Dokumente që dëshmojnë vendqëndrimin në Itali:** rezervimi hotelier ose Deklarata e Mikpritjes (Dichiarazione di ospitalità) për shoqëruesin ku të vërtetohet vendqëndrimi në Itali i këtij të fundit gjatë gjithë periudhës në të cilën personi i sëmurë i nënshtrohet trajtimeve mjekësore në spital. Deklarata e Mikpritjes mund të nënshkruhet nga një person fizik apo juridik italian apo nga çdo person tjetër fizik që banon rregullisht në Itali. Ajo duhet të shoqërohet nga një fotokopje e qartë e letërnjoftimit të garantuesit si edhe nga një fotokopje e qartë e Lejes së Qëndrimit në Itali (Permesso di Soggiorno) nëse garantuesi nuk është nënshtetas italian.
- 7) **Dokumente që dëshmojnë mjetet e transportit:** bileta e avionit vajtje/ardhje ose, nëse udhëtoni me makinë, fotokopje e qartë e dokumenteve të automjetit;
- 8) Vetëm për shoqëruesin: **Sigurim shëndetësor ndërkombëtar** i njohur nga Ambasada Italiane në Prishtinë; polica e sigurimit shëndetësor duhet të jetë e nënshkruar pranë njëres prej Kompanive vijuese të Sigurimit: **ADAC-VERSICHERUNGEN, ELSIG, ILLYRIA, KOSOVA E RE, SIGAL, SIGKOS, SIGMA e SIGURIA**; ajo duhet të jetë e vlefshme në të gjithë hapësirën territoriale të shteteve Schengen,

duhet të mbulojë shpenzimet spitalore në rast sëmundjeje dhe/ose aksidenti si edhe shpenzimet e nevojshme për riatdhesimin e kufomës në rast vdekjeje. Shuma siguruese minimale nuk duhet të jetë më e vogël se 30.000 Euro

**Kujdes: Renditja e Kompanive të Sigurimit të sipërshënuara është bërë në rend alfabetik dhe nuk shpreh, në asnjë mënyrë, asnjë preferencë zgjedhjeje nga ana e Sektorit të Vizave pranë kësaj Ambasade.**

**9) VETEM PER TE MITURIT NEN 18 VJEC:**

- **çertifikatë lindjeje** e të miturit e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile Ministria e Punëve të Brendshme, Prishtinë;

- **pëlqimi i prindit/prindërve** për të dalë jashtë Kosovës e cila jepet përpara zyrtarit të vizave pranë Ambasadës Italiane në Prishtinë me anën e një deklarate që të dy prindërit ose prindi që mbetet në Kosovë) duhet të nënshkruajnë personalisht përpara tij ose pranë një noteri.

**KUJDES:** dokumentet e lartëshënuar janë të vlefshëm vetëm për Kurimet Mjekësore të mbuluar me shpenzime personale. **Për rastet humanitare** dokumentacioni në pikat 4) dhe 5) zëvendësohet nga Vendimi Regjional (Delibera Regionale) mbi financimin e trajtimeve mjekësore të pacientit.

**AMBASADA ITALIANE PRISHTINE**